

Faton MURSELI
LAJMET E RREJSHME

Abstrakti: Në zhvillimin e madh të sotëm të teknologjisë e determinuar kjo me përhapjen më të gjerë, të shpejtë dhe origjinale të mesazhit mediatik nga burimi tek opinioni publik, rol e ndikim sidomos politik kanë lajmet e rrejshme – “fake news”. Ato janë pjesë e pandarë e identitetit virtual, por ndikojnë edhe në identitetin tonë real në qëndrime të caktuara. Në kohën e globalizimit, sidomos këto lajme janë bërë të shpeshta dhe me ndikim të madh në jetën sociale.

Ky punim shkencor ka për qëllim të trajtojë përpilimin e lajmeve të rrejshme për arritjen e rezultateve politike në negociata mes shteteve. Në mënyrë indirekte do të trajtojë raportin që mediat e reja përmes këtyre lajmeve vendosin me partitë politike apo imazhin që krijojnë ato medie në publik. Një lajm i vërtetë mund të përgënjeshtrohet apo një lajm i rremë mund të nxjerrë shumë të vërteta. Pra, sot bota gjendet në një ‘luftë kibernetike’, që normalisht zhvillohet përmes kompjuterëve të fuqishëm dhe komunikologëve profesionistë.

Punimi do të jetë një studim i ndikimit të këtij lloji komunikimi që krijohet nga mediet, te opinioni publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, njohjes së termeve të këtilla mediatike nga opinioni i këtushëm dhe ndikimi i këtij lloji të komunikimit në avancimin apo jo të shoqërisë në këtë pjesë. Studimi do të kryhet përmes metodës së anketimit, ndërkaq pjesë pikante të shfrytëzimit të lajmeve të rrejshme për qëllime të ndryshme si politike, ekonomike apo degraduese do të kryhen përmes metodës së analizës së përmbajtjes. Objekt vëzhgimi do të jenë portalet në gjuhën shqipe e me më shumë lexueshmëri në RMV, ndërkaq rezultatet e studimit do të ofrojnë pasqyrimin e ndikimit negativ apo pozitiv të lajmeve të rrejshme në standardin e jetës.

Fjalë kyçe: Lajmet e rrejshme, Mediat, Ndikimi social, ‘Lufta kibernetike’, globalizimi.

1. Hyrje

Nga fjalori i Kembrixhit, fjala “lajme të rrejshme”, ose në anglisht “fake news”, kuptohet si lajme të cilat informojnë për një ngjarje false apo inekzistente, që përhapen më shumë në internet apo edhe në media të tjera, dhe në të shumtën e rasteve krijohen për të pasur influenca politike apo edhe si shaka (dictionary.cambridge.org, n.d.).

Lajmet e rrejshme, me zhvillimin e sotëm, sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit të teknikës dhe teknologjisë kanë një përhapje të gjerë, sidomos në internet dhe si të tilla një ndikim të madh politik dhe shoqëror. Kjo mund të lidhet edhe me komercializimin dhe globalizimin e lajmeve të rrejshme, të cilat paraqesin një paradoks të madh të kohës së sotme. Për derisa ky “det i gjerë komunikimesh” marrë në aspektin global ofron një horizont të madh bashkëpunimesh dhe mundësish, lajmet e rrejshme përfaqësojnë një problem diskutabil, në veçanti tek vendet demokratike e në mënyrë specifike në Evropë dhe Ballkan (Imeraj, 2019).

Në kohën e sotme, globalizimi dhe komercializimi i lajmeve të rrejshme është një temë mjaft serioze. Kjo vjen si rezultat i shtrirjes më të madhe të informacionit, shkurtesës së kohës së informimit dhe mundësinë e qytetarisë aktive (Concha, 2010). Gjërat të cilat supozohet të ndihmojnë njerëzit, të bashkojnë dhe të bëjnë me të kuptueshme ngjarjet e përditshmërisë, në mënyrë të menjëhershme na kthehen në mjete për krijimin e një influence falco. Me ndihmën e internetit aktorët shtetërorë, ndonjë grup apo individë, janë në gjendje të influencojnë në aferat e ndonjë shteti tjetër. Me mundësinë e komunikimeve të sotme përmes mediave sociale ka kompani të cilat bëjnë lajme të rrejshme dhe simulojnë ndonjë produkt global që mund të jetë instrument në kampanja politike apo në tema të tjera të rëndësisë globale. Nuk ka dyshim se përpiluesit e lajmeve të rrejshme janë, në të shumtën e rasteve, njerëz inteligjent e të shkolluar dhe i dinë saktësisht se çfarë duan të arrijnë përmes tyre.

Ky punim shkencor ka rëndësinë e tij sepse fokusi i studimit është mostra e qytetarëve në rajonin e Pollogut, të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa është kryer me anë të metodës së anketimit, respektivisht anketimit “online”, përmes aplikacionit “google forms”, ku janë përgjigjur 250 të anketuar. Qëllimi i studimit është të nxjerrë konkluzione se a ekzistojnë lajmet e rrejshme, a ndikojnë ato në përcaktimin e rrjedhave sociale në vend, që më pastaj të vazhdohet me studime të tjera që janë në drejtim të dezinformimit, apo të komercializimit të informacioneve.

2. Lajmet e rrejshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Në gjuhën shqipe ka një fjalë që thotë “gënjeshtria i ka këmbët e shkurtra”, në sensin që ajo jeton shkurtë, por duke iu falënderuar mediave të reja dhe “portaleve fantazmë”, ndoshta kjo fjalë më nuk është e vërtetë (Imeraj, 2019). Lajmet e rrejshme tani më mund të qarkullojnë për muaj të tërë në rrjete apo në diskutime për çështje shtetërore dhe më pastaj është problematike që të ndalohet ky lajm. Po i përmendim këtu disa nga lajmet e rrejshme globale, të cilat ishin se NASA ka konfirmuar që bota do të jetë 15 ditë në errësirë. Trump do ta heq statujën e Lirisë apo edhe lajme të tjera të aktorëve të ndryshëm e të rëndësishëm që thuhet se janë me origjinë shqiptare.

Si të tilla, lajmet në përgjithësi kanë një ndikim tek opinioni publik, dhe pasi që nuk ekziston ndonjë mjet për të konfirmuar vërtetësinë e lajmit nga audienca, ndikim kanë edhe lajmet e rrejshme. Në të shumtën e rasteve ato krijohen për të arritur qëllime të ndryshme, si propagandistike, editoriale, apo diskredituese. Pra si të tilla lajmet e rrejshme përfaqësojnë një PR tekst që shtrinë ndikimin e tij në gjithë shoqërinë. Gjithmonë këto lajme kanë një qëllim të caktuar dhe ky është arritur në mënyrë graduale e që përputhet me politikat editoriale dhe ide personale. Duhet të kuptohet se lajmet e rrejshme nuk janë më një problem lokal apo fenomen i izoluar por kjo është një betejë globale dhe në luftë me lirinë e gjithsecilit dhe një sinjal që vendet botërore duhet të përmirësojnë filtrat informativ. Kjo është një betejë për lirinë e gjithsecilit, pasi që sipas studiuesve ndikon shumë në të drejtën bazike për lirinë e


informacionit. Parë në këtë këndvështrim, nëse jemi të lirë të konsumojmë informacione, mediat nuk janë të lira të “helmojnë opinionin” me të pavërteta.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pesëvjeçarin e fundit është shtuar tej mase konsumimi i informacionit nga interneti, dhe si pasojë janë shtuar edhe portalet informative. Këto portale informojnë shpesh opinionin me të pavërteta, propagandojnë pa argumente personalitete të caktuara apo diskreditojnë të tjerë. Është një shqetësim shumë i madh publik si për aktorët socialë, të cilët gjithnjë druhen nga devijimi i informatave që i japin, ashtu edhe për opinionin publik që sulmohet me informata të pavërteta. Kjo vjen si pasojë e komercializimit të portaleve informative, në të shumtën e rasteve për propagandim të ideve dhe ngjarjeve politike. Pasi që vitet e fundit në RMV është shqetësues fakti i emigrimeve, pikërisht gazetarët komercialë dhe sidomos portalet informative kanë kontribuar në paraqitjen e një realiteti të zyrtar në RMV, si të pa perspektivë, kurse nga ana tjetër kanë propaganduar një realitet ndryshe në vendet tjera Evropiane të BE-së. Shumë lajme të rrejshme janë përhapur për mundësi punësimi në vendet e Bashkimit Evropian dhe njerëzit janë përballur me dëshpërim, i cili tashmë është kolektiv.

2. Përhapja dhe ndikimi i lajmeve të rrejshme


Njerëzit sot janë të sulmuar nga një mirinformim që nënkupton një informim jo të besueshëm apo të mbushur me lajme të rrejshme. Këtë e nxjerr një studim me titull “siguria në internet dhe besueshmëria”, i përpiluar nga “Centre for International Governance Innovation” (“CIGI”) në harkun kohorë nga 21 dhjetor 2018 dhe 10 shkurt 2019. Ky studim i Institutit “Reuters” për të analizuar gazetarinë në Universitetin “Oxford” është bazuar në anketimin e 75.000 njerëzve në 38 vende të botës. Rezultatet e tij janë mjaft interesante dhe në këtë punim ne do ti ripublikojmë disa nga to për të pasur një pasqyrim më të gjerë të ndikimit dhe përhapjes së lajmeve të rrejshme.

E para, mendimi publik për keqinformimin është shumë i lartë ndërsa ai është rritur drastikisht në vitet e fundit në shumë vende të botës. Shumë nga të anketuarit mendojnë se ky keqinformim ndikon në jetën sociale të vendit (Report, 2019). Pasi që lajmet e rrejshme më shumë përhapen në internet e sidomos në mediat sociale, pjesa dërmuese e të anketuarve mendojnë se mediat sociale kanë rritur qasjen e tyre në informacion (grafikonët me të zeza).



Grafikoni 1: Rritja e ndikimit informativ nga rrjetet sociale ("CIGI", 2018)

Pasi që konstatohet se në mënyrë drastike është rritur ndikimi në informacione të mediave të reja e kryesisht të internetit, sipas po të njëjtit studim konstatohet se rrjetet sociale janë ata që përhapin më shumë lajme të rrejshme të cilat ndikojnë jetën politike, privatësinë, apo jetën e përgjithshme sociale. Përhapës më i madh i lajmeve të rrejshme është rrjeti social “facebook” me 67%, mediat tjera sociale me 65% dhe interneti në përgjithësi me 60%. Dhe kjo shihet qartë dhe në mënyrë të detajuar në grafikunin e mëposhtëm.



Grafikoni 2: Shpërndarësit më të mëdhenj të lajmeve të rrejshme ("CIGI", 2018)

3. Ndikimi i lajmeve të rrejshme

Lajmet e rrejshme sot qarkullojnë shumë në botën e civilizuar, por, ato kanë një qarkullim të madh në teknologjinë e sotme digjitale dhe transformimin e përgjithshëm të medias. Sidomos politikanët tentojnë që çdo herë ta zbkurojnë të vërtetën dhe kështu në shumë raste ata gënjejnë dhe kjo ka ndodhur qysh në demokracinë athinase, 2.500 vite më parë, sipas studiuesit David Schrieberg, madje edhe çmimin “Pulitzer” e fitojnë gjithnjë e më shumë gazetarët të cilët krijojnë lajme interesante për klientët të Korporatave.

Deri sa në të kaluarën përsëri ka pasur më shumë të vërteta, sidomos në sferën publike, pasi që atë botë transmetimet janë bazuar kryekëput në fjalën verbale (Agee, 1974). Ndërkaq, lajmet e rrejshme fillojnë të lindin dhe të përsosen me zhvillimin e teknologjisë dhe janë të pranishme në faqet e internetit. Ndikimi i tyre është shumë i madh në kohën e sotme vetëm të përmendim panikun e shkaktuar në vitet e '30-ta nga një gazetarë amerikan, që dezinformonte për praninë e "Alienëve" në hapësirë, e të cilët janë rrezik për njerëzimin sipas tij. Pra çfarë e bënë këtë fenomen të ndryshëm, më shumë shqetësues në ditët e sotme ? Qëllimi i mediave digjitale është të jenë kritike në procesin e demokratizimit të vendeve, mirëpo lajmet e rrejshme e tjetërsojnë këtë qëllim, duke u bazuar në studiuesin Tom Glocer, sot familjet më shumë se sa procese të brendshme dhe globale politike janë të interesuara për ndodhi që i ndikojnë ata, mënyrën e jetesës së tyre apo të një grupi të caktuar. Glocer thotë që teknologjia sot ka të lehtë të krijojë disa informacione që dekada më parë ishin të paimagjinueshme, madje edhe të devijojnë fjalët publike apo mesazhet e dhëna. Dhe kjo quhet një orvatje për të krijuar lajme të rrejshme dhe për të ndikuar opinionin për të arritur qëllime të caktuara. Këtu fillon propaganda e cila nuk është provë e ekzistencës së komunikimit bindës, por më tepër sot një ndryshim mjjetesh për arritje të qëllimeve të caktuara (Maigret, 2010). Gjithë këtë rrugë marketingu, Bon e definon si bindje të turmave në konceptin psikologjik, në të cilën përveç shkaqet e dukshme shpesh fshihen edhe shkaqe të padukshme (Bon, 2012).

Në kohën e sotme, vetëm me një kompjuter dhe në faqe interneti, ne mund të krijojmë një gazetë, mund të krijojmë një portal apo në rrjetet sociale mund të publikojmë gjithçka. Kjo liri e madhe e shprehjes, sipas studiuesit Denver, është keqinterpretuar dhe keqpërdorur në shumë raste. Fatkeqësisht në shumë vende të botës, pra edhe në RMV, nuk ekziston një filtër për testimin e vërtetësisë së informatave që plasohen në opinionin publik. Si pasojë ndodh një përzierje e informacioneve të vërteta dhe lajmeve të rrejshme që ka ndikim negativ në shoqëri. Edhe pse individët kanë liri të për t'u informuar, kjo jo domosdoshmërisht duhet të kuptohet lirinë për të informuar.


4. Lista e tabelave dhe grafikonëve

Ky punim shkencor, mbështetet në hulumtimet tona të kryera me metodën e anketimit 'online' përmasa aplikacionit 'google forms', të plotësuar 250 pyetësorë të moshave të mesme të Republikës së Maqedonisë së Veriut e kryer në muajt gusht-shtator 2019.

Pasi që siç kemi theksuar studimi me anë të metodës së anketimit do të studiohen në bazë të përgjigjeve nga pyetjet e stilit të mbyllur të moshës dhe të nivelit të arsimimit, po ju paraqesim rezultatet e këtyre dy indikatorëve:

2. Moshë juaj

142 responses




Grafikoni 3: Përgjigjet e pyetjes: Moshë juaj?

Siç shihet, pjesa më e madhe e të anketuarve 75.4% janë të moshës nga 18 deri 22 vjet, 19.7% janë të moshës nga 22 deri 40 vjet, ndërsa pjesa tjetër janë nga 44 deri 60 vjet.

Në grafikun 4 do të jetë i paraqitur një indikatorë tjetër ku është fokusuar ky studim, në nivelin e arsimimit të të anketuarve që është i ndarë në tre nivele.

3. Arsimimi


142 responses



Grafikoni 4: Përgjigjet e pyetjes: Arsimimi?


Siç shihet, pjesa më e madhe e të anketuarve janë të arsimimit të lartë profesional, të diplomuar, magjistër apo doktorë të shkencave, respektivisht 77.5%. Me shkollim të mesëm janë 21.8% e të anketuarve, ndërsa pjesa tjetër janë me shkollim fillorë.

Është interesant të përmendet fakti që në pyetjen se a është pozitiv apo negativ fenomeni i futjes së risive informative në zhvillimin e sotëm të teknikës dhe të teknologjisë, pjesa dërmuese e të anketuarve janë përgjigjur se ky është një fenomen negativ. Kjo na bën të kuptojmë që qytetarët në RMV kanë humbur besimin tek informacionet që plasojnë në të shumtën e rasteve portalet informative.



Grafikoni 5: A është pozitiv apo negativ fenomeni i futjes së risive informative

Edhe përkundër që qytetarët janë të vetëdijshëm për ekzistencën e lajmeve të rrejshme dhe ndikimin e tyre të gjerë social, ata përsëri në masë të madhe përdorin portalet informative për t'u informuar. Kështu që në pyetjen se a jeni në dijeni dhe a i dalloni lajmet e rrejshme në portalet informative qytetarët janë përgjigjur me po në 27% e të anketuarve.



Grafikoni 6 : A jeni ne dijeni dhe a i dalloni lajmet e rrejshme

Kështu që në mediat e sotme në RMV, ka një rënie të madhe të besueshmërisë së tyre, e prandaj pjesa dërmuese e të anketuarve janë përgjigjur se dëshirojnë më shumë të informohen nga mediat klasike, siç janë televizioni, radioja apo gazetat. Ndërkaq mediat e reja e sidomos portalet informative kanë humbur sot besueshmërinë e lajmeve që plasojnë.

5. Konkluzat

Ky studim me titull “lajmet e rrejshme”, ka sjellë disa përfundime disa prej të cilave janë të pritshme ndërsa disa janë befasuese.

- Përfundimi i përgjithshëm i hulumtimit është se lajmet e rrejshme përbëjnë sot një problem global, pra si të tilla problem edhe për vendin tonë Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ato ndikojnë jetën tonë sociale në marrjen e vendimeve të ndryshme sidomos të sferës politike.
- Përfundim tjetër i hulumtimit është se për shkak se lajmet e rrejshme janë më të përhapura në internet apo më saktësisht në portalet informative, qytetarët kanë humbur besimin tek informimi nga ta.
- Ndërkaq përfundim befasues është fakti që qytetarët e RMV-së gjithnjë e më tepër si burim informacionesh përdorin mediat tradicionale televizionet, radiot apo gazetat, dhe janë shumë skeptik nga dobitë e botës globale të përparimit të teknikës dhe të teknologjisë.
- Madje, përfundim befasues është fakti që qytetarët janë shprehur se zhvillimi i sotëm i teknikës dhe teknologjisë dëmton në masë të madhe familjen dhe shoqërinë në përgjithësi, stimulon emigrimet e paqëllimta dhe sjell deri te zhgënjimet sociale.

Bibliografia

- "CIGI", C. f. (2018, Dhjetor 21). *CIGI*. Retrieved from <https://www.cigionline.org/>
- Agee, P. (1974). *Inside the Company: CIA Diary*. NY: Bantam Books .
- Bon, G. L. (2012). *Psikologjia e popujve dhe e turmave*. Tiranë: Fan. S. Noli.
- Concha, E. (2010). Journalism's future in hybrid and adapts to all supports. *Infoamerica*, 119-128. Retrieved from <https://www.infoamerica.org/icr/n02/edo.pdf>
- dictionary.cambridge.org*. (n.d.). Retrieved from <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/fake-news>
- Imeraj, A. (2019). Globalizimi dhe komercializimi i lajmeve te rrejshme. *Diplomat Magazine*, 6.
- Maigret, E. (2010). *Sociologjia e komunikimit dhe e mediave*. Tiranë: Papirus.
- Report, D. N. (2019). Siguria e internetit dhe besimi. *CIGI*, 8-19.